

Plani Vjetor i Financimit i Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara

Në pikën 4 të VKM-së 110/2019, parashikohet shprehimisht se: “*Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit që përmban:*

a) shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal;

b) objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuara;

c) numrin e përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse të autorizuara që mund të përfshihen në procesin epërzgjedhjes;ç) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe

d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Shuma e përfitimit financiar për vitin fiskal:

Buxheti i miratuar ka përcaktuar për dhënien e ndihmes juridike parësore për individët që plotesojnë kushtet, në zbatim të ligjit për ndihmën Juridike Falas ***në total është në vlerën 8,000,000 lekë.***

Objektivat e përfitimit financiar sipas objektivave të identifikuara:

Dhënia e ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*” në mënyrë profesionale, cilësore, efëçente dhe efektive;

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*” ndihmë juridike parësore nënkuptohet vetëm ndihma juridike e dhënë fizikisht për qytetarët (*përmes nënshkrimit të formularëve tip të deklarimit*) dhe jo ndihma juridike online;

Ndihma juridike do të ofrohet pranë zyrës/ambienteve në të cilën operon organizata jofitimprurëse e autorizuar;

Ndihma juridike do të ofrohet për të gjithë kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, pa u ndalur në trajtimin e rasteve të veçanta sipas objektivit të veprimtarisë së OJF-ve;

Numri i përfaqësuesve të organizatave që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë mund të përfshihen në procedurën e përzgjedhjes.

Në kushtet kur, referuar pikës 21 të VKM nr. 110/2019, çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar e përzgjedhur nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti për organizatat jofitimprurëse. Numri i organizatave që mund të mbulohen me fondet e vitit 2022, është të paktën 5 (pesë) organizata.

Do të shpallen fituese të financimit, Organizatat Jofitimprurëse me pikët më të larta vlerësuar nga Komisioni përkatës.

Vlera maksimale e financimit për një organizatë sipas VKM nr. 110/2019	Numri minimal i organizatave të mund të përfitojnë financim
20% e 8.000.000 lekë= 1.600.000 lekë	8.000.000 lekë/1.600.000 lekë= 5 Organizata

Koha e fillimit të zbatimit të ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti:

Nëse i referohemi afateve procedurale të përcaktuara në VKM 110/2019, lidhja e kontratave të financimit parashikohet të realizohet brenda 3 muajve nga shpallja e thirrjes.